

REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E ARSIMIT
SPORTIT DHE RINISË
DREJTORIA ARSIMORE RAJONALE E QARKUT TIRANË



Nr 356 Prot.

Tiranë, më 27.02...2018

NJOFTIM PËR VEND TË LIRË PUNE

Drejtoria Arsimore Rajonale e Qarkut Tiranë në zbatim të ligjit Nr.69/2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", të Urdhërit Nr.344, datë 19.08.2013 "Për ngritjen e njësisë së shërbimit psiko-social", shpall konkurimin për **3(tre)** vende të lira për **zëvendësim leje lindje** në pozicionin **Psikolog**, në Njësinë e Shërbimit Psiko-Social të shkollave në varësi të Drejtorisë Arsimore Rajonale të Qarkut Tiranë: Shkolla e mesme Yzberisht, shkolla e mesme e bashkuar Ibë dhe shkolla e mesme e bashkuar Krrabë

KËRKESA TË VEÇANTA PËR KANDIDATËT.

Psikologu: Të ketë mbaruar arsimin e lartë, në fushën e Psikologjisë (Diplomë universitare "Bachelor" në degën e Psikologjisë, si dhe studime Master Shkencor në Psikologjinë Shkollore ose "Psikologji Klinike"

- Të ketë njohuri të mira të një gjuhe të huaj, me përparësi gjuhën angleze.
- Të zotërojë njohjen e programeve bazë kompjuterike.
- Të ketë aftësi të mira menaxhuese, komunikuese dhe të punës në grup.

Paraqitja e dokumenteve: Kandidati duhet të paraqesë brenda orës 16.00 të datës 05.03.2018 ,në Sekretarinë e Drejtorisë Arsimore Rajonale të Qarkut Tiranë, me adresë: Rruga "Aleksandër Moisiu", Tiranë, këto dokumenta: Kërkesën për Aplikim, CV-në, fotokopje të diplomës dhe librezës së notave, të librezës së punës, të çertifikateve të kualifikimit, dëshmime të gjuhëve të huaja dhe kompjuterit, vërtetimin e gjendjes gjyqësore (dëshmi penaliteti të lëshuar Brenda 3 muajve) si dhe të paktën 1(një) letër rekomandimi nga punëdhënësi i mëparshëm, një numër telefoni për tu kontaktuar si dhe adresën e plotë të vendqëndrimit. (Mosparaqitja e plotë e dokumentave sjell s'kualifikim të kandidatit).

Pas verifikimit të dokumentave, me datë **07.03.2018**, do të njoftoheni për procedurën në vazhdim.

DREJTOR

Eglantina METANI

